


269849



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

853

V E N D I M

Nr. 292, datë 17.5.2006

KESHILLI I MINISTRAVE
Drejtori i Mbrojtjes
Përkrahës i Mbrojtjes

P Ë R

DHËNIEN NË PËRDORIM DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AVIACIONIT CIVIL TË DISA MJEDISEVE, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 90¹, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 3, pika 4, e 10, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", më propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie në përdorim, Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, për një afat 10-vjeçar, të dy mjediseve, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, si më poshtë vijon:
 - a) një sipërfaqe toke prej 600 m², pjesë e pronës me nr.223, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) një sipërfaqe toke prej 600 m², pjesë e pronës me nr.806, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i

book →

kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave. "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil të lidhin një marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA


MINISTRI I MBROJTJES



FATMIR MEDIU

NR.PROT.1528/1
DATË 23.5.2006

PRËSIDENCËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE



Myqerem TAFAJ

Sekretar i Përgjithshëm